



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1162/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: aMuharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala nëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Sylejman Reçicës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1162, Anr.1163, të datës 03.12.2013, të Sylejman Reçicës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (PDK) dega në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1162, Anr.1163, të datës 03.12.2013, të Sylejman Reçicës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1162/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në KKZ nuk po përputhen votatat me FPR me ato të KQZ-së, pra në QV 130E/04D figurojnë 09 vota ku duhet të jenë 16 vota. Më tutja ka theksuar se në QV1301E/03R janë 02 vota por duhet të jenë 07, në QV1304E/01R janë 02 vota por duhet të jenë 22, në QV1304E/03D janë 0 vota por duhet të jetë 01, në QV1317E/01R janë 02 vota por duhet të jenë 27, në QV1322E/01R janë 0 vota por duhet të jetë 1, pra ndryshimi është 51 vota më pak, prandaj kërkoi rishikimin e formularit në këto VV.
- Në ankesën Anr.1163/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV ka pasur ndryshime të formularëve nga gjendja faktike në dëm timin. Pra në QV 1329E/01R/02D mungojnë 9 vota, në QV1328/01R/02R/03D mungojnë mbi 10 vota, në QV 1301X/01R/02R/03R/04D mungojnë 17 vota, në QV1327/01R/02R/03D mungojnë 9 vota, në QV132C/01R/02R/03R/04R/05R/06R/07D mungojnë 10 vota, prandaj kërkoi rinumërimin e këtyre QV. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një fletëlist të kandidatëve për Kuvend Komunal.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Sylejman Reçicës – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 1162/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.